

KEP Trust

Raporti dyvjeçar i qëndrueshmërisë

2024–2025

Pasqyrë e performancës mjedisore, sociale dhe qeverisëse

Pasqyrë e performancës MSQ e fokusuar në financa të përgjegjshme, rritje gjithëpërfshirëse, ndikim në komunitet, qeverisje dhe menaxhim mjedisor.

Periudha e raportimit

1 janar 2024 – 31 dhjetor 2025

Përgatitur nga

KEP Trust



Përmbajtja

Shkurtesat	3
Rreth raportit	4
Porosi nga KE.....	5
1. KEP Trust në një vështrim të shkurtër	6
1.1. Struktura organizative dhe menaxhmenti i lartë	6
1.1.1. Qeverisja e MSQ/qëndrueshmërisë.....	7
1.2. Historiku	8
1.3. Vizioni, misioni, vlerat	8
1.4. Pasqyra aktuale (2024–2025)	8
2. Qasja e qëndrueshmërisë	10
2.1. Strategjia dhe menaxhimi i qëndrueshmërisë	10
2.1.1. Harta e aktiviteteve të OZHQ-së	11
2.2. Vazhdimi i ndërtimit nga baza ekzistuese e qëndrueshmërisë	13
3. Qeverisja Korporative	14
3.1. Parimet dhe politikat e qeverisjes korporative, Parimet etike	14
3.2. Transparenca dhe raportimi	16
3.3. Qasja ndaj menaxhimit të rrezikut.....	17
4. Përgjegjësia sociale	18
4.1. Vlera për shoqërinë.....	18
4.1.1. Produktet dhe shërbimet.....	18
4.1.2. Gjithëpërfshirja financiare	19
4.1.3. Mbrojtja e klientëve.....	19
4.1.4. Qasja ndaj përgjegjësisë sociale korporative.....	20
4.1.5. Bashkëpunimet, donacionet dhe sponsorimet.....	20
4.2. Vlera për punonjësit.....	22
4.2.1. Profili i punonjësit	22
4.2.2. Qasja ndaj burimeve njerëzore.....	23
5. Përgjegjësia mjedisore	26
5.1. Gjurma mjedisore	26
5.2. Vlerësimi i rrezikut mjedisor dhe social në aktivitetet e kredithënies.....	27
5.3. Ndryshimet klimatike dhe menaxhimi mjedisor.....	27
Deklarata përmbyllëse	29

Shkurtesat

Shkurtesa	Kuptimi
PPP	Parandalimi i pastrimit të parave
BD	Bordi i Drejtorëve
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
KF	Kryeshefi Financiar
CO₂	Dioksidi i karbonit
PSK	Përgjegjësia Sociale Korporative
M&S	Mjedisor dhe social
SMM	Sistemi i menaxhimit mjedisor
MSQ	Mjedisore, sociale dhe qeverisëse
BE	Bashkimi Evropian
DBGjN	Dhuna me bazë gjinore dhe ngacmimi
GHG	Gazra serrë
BNJ	Burimet njerëzore
IFC	Korporata financiare ndërkombëtare
TI	Teknologjia e informacionit
TKP	Treguesi kyç i performancës
BM	Bordi Menaxhues
IMF	Institucion mikrofinanciar
PCAF	Partneriteti financiar për kontabilitetin e karbonit
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
SMSM	Sistemi i Menaxhimit Social dhe Mjedisor
NVM	Ndërmarrje e Vogël dhe e Mesme
TPS	Treguesit e Performancës Sociale
tCO₂e	Tonë ekuivalent të dioksidit të karbonit
TCFD	Task Forca për Shpalosjet Financiare në Lidhje me Klimën

Rreth raportit

Ky Raport dyvjeçar i qëndrueshmërisë paraqet një pasqyrë të performancës mjedisore, sociale dhe qeverisëse (MSQ) të KEP Trust për periudhën e raportimit 2024–2025. Ai mbështetet në Raportin e parë të Qëndrueshmërisë të KEP Trust dhe pasqyron përkushtimin e vazhdueshëm të institucionit ndaj rritjes së përgjegjshme, transparencës dhe vlerës afatgjatë për palët e tij të interesit.

Raporti mbulon periudhën nga 1 janari 2024 deri më 31 dhjetor 2025 dhe përshkruan qasjen, veprimet dhe progresin e KEP Trust në fushat kyçe të qëndrueshmërisë. Ai është përgatitur për të treguar se si qëndrueshmëria po integrohet në qeverisje, operacione, aktivitete të kredithënies, zhvillimin e punonjësve, digjitalizim dhe menaxhim mjedisor. Aty ku është relevante, janë përfshirë referenca ndaj periudhave paraprake për të treguar progresin, vazhdimësinë dhe fushat për përmirësim të mëtejshëm.

Duke ecur përpara, KEP Trust synon të publikojë raporte të qëndrueshmërisë në baza vjetore, duke forcuar më tej transparencën, llogaridhënien dhe komunikimin e rregullt me palët e interesit.

Ndryshe nga raporti i parë, i cili u përqendrua në përcaktimin e bazës dhe kornizës fillestare të qëndrueshmërisë, ky edicion mbështetet drejtpërdrejt në raportin paraprak dhe në progresin e arritur që atëherë. Gjatë kësaj periudhe, KEP Trust ka zbatuar dhe avancuar veprime të formësuar nga palët e brendshme dhe të jashtme të interesit, duke përfshirë punonjësit, klientët, partnerët e biznesit dhe organizatat ndërkombëtare që mbështesin financimin e bazuar në ndikim. Këto zhvillime kanë ndihmuar në qartësimin e prioritetëve të qëndrueshmërisë së KEP Trust dhe kanë forcuar kuptimin e institucionit mbi efektet ekonomike, sociale dhe mjedisore të aktiviteteve të tij. Prandaj, ky raport pasqyron njëkohësisht vazhdimësinë në raportim dhe zhvillimin gradual të qasjes së qëndrueshmërisë së KEP Trust përmes përvojës, angazhimit të palëve të interesit dhe zbatimit praktik.

Ky raport është përgatitur brenda KEP Trust dhe nuk i është nënshtruar auditimit të jashtëm apo sigurisë së pavarur. Informacioni i paraqitur bazohet në të dhënat e brendshme, të dhënat e disponueshme të aktiviteteve, informacionet e menaxhmentit dhe supozimet përkatëse metodologjike të disponueshme në kohën e përgatitjes.

KEP Trust fton që komentet, sugjerimet apo idetë për përmirësimin e këtij raporti të dërgohen në Departamentin e menaxhimit të organizimit dhe proceseve në adresën **kepesg@keptrust.org**. Komentet e palëve të interesit dhe angazhimi i vazhdueshëm janë të rëndësishme për forcimin e punës sonë për qëndrueshmëri dhe raportimin e ardhshëm.

Porosia nga KE

Të nderuara palë të interesit,

Kam kënaqësinë të paraqes Raportin dyvjeçar të qëndrueshmërisë të KEP Trust për vitet 2024–2025, si pasqyrim i rritjes sonë të vazhdueshme dhe i përkushtimit tonë të përbashkët për të ndërtuar një të ardhme më të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Si institucion mikrofinanciar që u shërben ekonomive familjare, ndërmarrësve, fermerëve dhe bizneseve të vogla në mbarë Kosovën, ne besojmë se financat kanë fuqinë jo vetëm të mbështesin jetesën, por edhe të forcojnë komunitetet, të krijojnë mundësi dhe të kontribuojnë në progres të qëndrueshëm.

Gjatë kësaj periudhe raportimi, KEP Trust ka avancuar me besim, duke zgjeruar shtrirjen dhe portofolin, duke investuar në digjitalizim dhe në njerëz, duke forcuar qeverisjen dhe duke integruar më thellë konsideratat mjedisore dhe sociale në vendimmarrjen e përditshme. Qëndrueshmëria nuk shihet më vetëm si kërkesë raportimi; ajo po bëhet pjesë e mënyrës se si mendojmë, operojmë, japim kredi dhe rritemi si institucion.

Progresi ynë nxitet nga besimi i klientëve tanë, përkushtimi i punonjësve tanë dhe përgjegjësia që ndiejmë ndaj komuniteteve të cilave u shërbejmë. Përmes kredithënies së përgjegjshme, mbrojtjes më të fuqishme të klientëve, mbështetjes për bizneset dhe ekonomitë familjare të udhëhequra nga gratë, nismave të komunitetit, zhvillimit të punonjësve dhe matjes së përmirësuar mjedisore, ne vazhdojmë të lidhim suksesin institucional me ndikimin pozitiv. Duke parë përpara, do të mbetemi të përqendruar në të mësuarit, përmirësimin e cilësisë së të dhënave, vendosjen e qëllimeve realiste dhe forcimin e kontributit tonë në zhvillimin e qëndrueshëm. Në emër të Bordit Menaxhues, i falënderoj të gjitha palët e interesit për besimin dhe partneritetin e tyre të vazhdueshëm në rrugëtimin e KEP Trust drejt rritjes së përgjegjshme dhe të qëndrueshme.

Sinqerisht,

Adrian Alo

Kryeshef Ekzekutiv



1. KEP Trust në një vështrim të shkurtër

I themeluar në vitin 1999, KEP Trust është një nga institucionet kryesore mikrofinanciare në Kosovë, me prani të fuqishme në treg dhe shtrirje të gjerë në të gjithë vendin. Përmes Zyrës Qendrore në Prishtinë dhe rrjetit prej 31 degësh, KEP Trust ofron shërbime financiare të qasshme për individë, mikrondërmarrje, fermerë dhe biznese shumë të vogla, duke vazhduar njëkohësisht të forcojë cilësinë e shërbimit, digjitalizimin dhe efikasitetin operacional. Me kalimin e viteve, institucioni është zhvilluar nga një nismë e orientuar drejt zhvillimit në një institucion financiar të besueshëm, të fokusuar në rritje të përgjegjshme, mbrojtje të klientëve, përfshirje financiare dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Që nga regjistrimi i tij si institucion mikrofinanciar në vitin 2002, KEP Trust ka zgjeruar portofolin e tij, ka forcuar qeverisjen dhe menaxhimin e rrezikut dhe ka thelluar rolin e tij në mbështetjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Sot, institucioni ndërthur performancën financiare me një përkushtim në rritje ndaj parimeve mjedisore, sociale dhe qeverisëse, duke pranuar se zhvillimi i qëndrueshëm kërkon rezultate të fuqishme financiare, kredidhënie të përgjegjshme, qeverisje të shëndoshë, zhvillim të punonjësve dhe menaxhim të kujdesshëm të ndikimit social dhe mjedisor.

1.1. Struktura organizative dhe menaxhmenti i lartë

Struktura organizative e KEP Trust mbështet qeverisjen e shëndoshë, operacionet efektive dhe rritjen institucionale të qëndrueshme. Qeverisja bazohet në ndarjen e qartë të përgjegjësiave ndërmjet Bordit të

Drejtorëve dhe Bordit Menaxhues, duke mbështetur mbikëqyrjen strategjike dhe menaxhimin e përgjegjshëm të përditshëm.


Bordi i Drejtorëve përbëhet nga pesë anëtarë të pavarur dhe është përgjegjës për drejtimin strategjik, mbikëqyrjen, llogaridhënien dhe vendimmarrjen e balancuar në përputhje me misionin, vlerat dhe prioritetet afatgjata të zhvillimit të KEP Trust. Bordi Menaxhues, i udhëhequr nga Kryeshefi Ekzekutiv, mbikëqyr zbatimin, performancën operationale dhe koordinimin në funksionet kyçe, përfshirë financat, aktivitetet komerciale, burimet njerëzore, rrezikun, teknologjinë e informacionit dhe zhvillimin e biznesit.

1.1.1. Qeverisja e MSQ/qëndrueshmërisë

Brenda kësaj strukture, koordinimi i qëndrueshmërisë mbështetet përmes rolit të Udhëheqësit të menaxhimit të organizimit dhe proceseve, i cili shërben edhe si Zyrtar i MSQ-së, ndërsa Kryeshefi Financiar ofron mbikëqyrje të nivelit të lartë për çështjet mjedisore dhe sociale. Kjo strukturë ndihmon që qëndrueshmëria të pasqyrohet gjithnjë e më shumë në proceset operationale, mbikëqyrjen e kredithënies, raportimin e brendshëm dhe planifikimin institucional.

Karakteristikat kyçe të kësaj strukture përfshijnë:

- një kornizë organizative të qartë dhe transparente;
- përgjegjësi, linja raportimi dhe kompetenca vendimmarrëse të përcaktuara në nivelet e qeverisjes dhe menaxhmentit;
- politika, procedura dhe përshkrime të punës brendshme që mbështesin zbatimin dhe mbikëqyrjen;
- koordinim ndërfunksional për trajtimin e çështjeve të qeverisjes, rrezikut, pajtueshmërisë dhe qëndrueshmërisë në mënyrë të integruar.



*Korniza e qeverisjes së MSQ-së e paraqitur këtu plotëson strukturën më të gjerë institucionale të qeverisjes korporative të KEP Trust**

1.2. Historiku

Arritjet kyçe të mëposhtme theksojnë fazat kyçe në zhvillimin institucional të KEP Trust me kalimin e kohës:



1.3. Vizioni, misioni, vlerat

Vizioni, misioni dhe vlerat e KEP Trust vazhdojnë të jenë të përqendruara në përmirësimin e standardeve të jetesës dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës përmes shërbimeve financiare të qasshme, të përgjegjshme dhe të fokusuara te klienti. Në thelb të këtij misioni qëndron përkushtimi afatgjatë ndaj përfshirjes financiare, shërbimit të bazuar në marrëdhënie dhe mbështetjes për individët, fermerët, ndërmarrësit dhe bizneset që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal.

Me evoluimin e institucionit, këto parime themelore janë plotësuar gjithnjë e më shumë nga një perspektivë më e fuqishme mjedisore, sociale dhe qeverisëse. Sot, vlerat e KEP Trust pasqyrohen jo vetëm në kredithënien e përgjegjshme dhe mbrojtjen e klientëve, por edhe në vëmendjen ndaj sjelljes etike, zhvillimit të punonjësve, efikasitetit operacional, përgjegjësisë mjedisore dhe ndikimit më të gjerë të aktiviteteve të tij të financimit.


Në këtë kontekst, misioni dhe vlerat e KEP Trust ofrojnë bazën për qasjen e tij të qëndrueshmërisë: ndërthurjen e performancës financiare me qeverisjen e përgjegjshme dhe një fokus në rritje në gjenerimin e rezultateve pozitive sociale dhe mjedisore me kalimin e kohës.

1.4. Pasqyra aktuale (2024–2025)

Në periudhën e raportimit 2024–2025, KEP Trust paraqet një profil më të fuqishëm institucional, të shënuar nga rritja e vazhdueshme e portofolit, kapaciteti i zgjeruar operacional dhe integrimi më i thellë i qëndrueshmërisë në drejtimin e tij të përgjithshëm. Në vitin 2025, KEP Trust operoi përmes 32 zyrave, të përbëra nga 31 degë dhe Zyra Qendrore, me një sipërfaqe totale operimi prej 6,185 m² dhe 275 punonjës, nga 265 sa ishin në vitin 2024. Gjatë së njëjtës periudhë, portofoli total i institucionit u rrit nga 116.09 milionë € në vitin 2024 në 139.69 milionë € në vitin 2025, ndërsa totali i aseteve u rrit nga 121.38 milionë € në 149.54 milionë € dhe huamarrjet u rritën nga 84.15 milionë € në 106.57 milionë €. Së bashku,

këto shifra pasqyrojnë rritjen e biznesit dhe kapacitet më të fuqishëm financimi, duke mbështetur shtrirje më të gjerë dhe duke ruajtur misionin e KEP Trust për t'u shërbyer ekonomive familjare, ndërmarrësve, fermerëve dhe bizneseve në mbarë Kosovën.

KEP Trust Growth Snapshot (2024–2025)



Kjo periudhë pasqyron gjithashtu progresin e KEP Trust në forcimin e themeleve institucionale që mbështesin rritjen e qëndrueshme. Krahas zgjerimit financiar, organizata ka vazhduar të investojë në digjitalizim, përmirësim të proceseve, zhvillim të stafit, integrim të MSQ-së dhe menaxhim të rrezikut mjedisor dhe social në kredidhënie dhe operacione. Këto zhvillime tregojnë se pozicioni aktual i KEP Trust formësohet jo vetëm nga shkalla, por edhe nga qeverisja, sistemet operacionale dhe praktikat e qëndrueshmërisë më të fuqishme.

Sot, KEP Trust ndërthur shtrirjen e gjerë në treg me një përkushtim në rritje ndaj financave të përgjegjshme dhe vlerës afatgjatë. Profili i tij aktual pasqyron rritjen operacionale dhe të portofolit, si dhe një njohje më të qartë të rolit të qeverisjes, angazhimit të punonjësve, pritjeve të palëve të interesit, përgjegjësisë mjedisore dhe financimit të orientuar drejt ndikimit në zhvillimin institucional të qëndrueshëm.



2. Qasja e qëndrueshmërisë

2.1. Strategjia dhe menaxhimi i qëndrueshmërisë

Gjatë periudhës së raportimit 2024–2025, KEP Trust vazhdoi të forcojë qasjen e tij të qëndrueshmërisë duke kaluar përtej fazës fillestare të bazës dhe duke integruar më aktivisht konsideratat mjedisore, sociale dhe qeverisëse në operacione, qeverisje, praktikat e kredithënies dhe raportim. Qëndrueshmëria trajtohet gjithnjë e më shumë si prioritet institucional ndërsektorial, i formësuar nga zhvillimi i brendshëm, pritjet e palëve të interesit, konteksti rregullator dhe bashkëpunimi me partnerët e jashtëm dhe financuesit e orientuar drejt ndikimit.

Brenda strukturës aktuale organizative, përgjegjësia për koordinimin dhe zbatimin e nismave të qëndrueshmërisë i përket Udhëheqësit të menaxhimit të organizimit dhe proceseve, i cili shërben si Zyrtar i MSQ-së, ndërsa mbikëqyrja e nivelit të lartë për çështjet mjedisore dhe sociale mbështetet në nivel të menaxhmentit. KEP Trust vazhdon të zbatojë Sistemin e tij të Menaxhimit Social dhe Mjedisor (SMSM), të krijuar në vitin 2021 në përputhje me udhëzimet e Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC), si mjet kyç për identifikimin, kategorizimin dhe menaxhimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale që lidhen me aktivitetet e kredithënies. Politika dhe Procedura e SMSM-së përcaktojnë rolet, përgjegjësitë dhe hapat e vlerësimit, duke përfshirë kategoritë e mëposhtme të rrezikut:

- Kategoria A: Rrezik i lartë
- Kategoria B: Rrezik i mesëm

- Kategoria C: Rrezik i ulët
- Kategoria D: Ndikim pozitiv

Ky sistem mbështet një rishikim të strukturuar të aktiviteteve të kredidhënies dhe ndihmon që rreziqet e mundshme mjedisore dhe sociale të merren parasysh në mënyrë të qëndrueshme në të gjithë portofolin. Paralelisht, KEP Trust ka vazhduar të forcojë praktikën më të gjera të qëndrueshmërisë përmes koordinimit të brendshëm, përmirësimit të mbledhjes së të dhënave, matjes së gjurmës mjedisore, angazhimit të palëve të interesit, digjitalizimit dhe integritit gradual të konsideratave të lidhura me MSQ-në në raportim dhe vendimmarrje.

Krahasuar me drejtimin e orientuar nga e ardhmja të përshkruar në raportin paraprak, KEP Trust ka avancuar disa elemente të rëndësishme të qasjes së tij të qëndrueshmërisë gjatë periudhës së raportimit 2024–2025. Në të njëjtën kohë, institucioni pranon se caqet formale të qëndrueshmërisë duhet të përcaktohen mbi bazën e një trendi më të gjatë historik, në mënyrë që zotimet e ardhshme të jenë si ambicioze ashtu edhe realiste.

- strategjia e qëndrueshmërisë dhe korniza përkatëse e politikave janë përditësuar;
- është përmirësuar kuptimi praktik dhe zbatimi i standardeve dhe kriterëve MSQ brenda ciklit të kredidhënies;
- matja e gazrave serrë ka kaluar nga emetimet operacionale në një inventar më të gjerë që përfshin edhe emetimet e portofolit;
- vazhdimi i përmirësimit të sistemeve të brendshme, mbledhjes së të dhënave dhe praktikave të raportimit që mbështesin menaxhimin e qëndrueshmërisë; dhe
- përgatitja e bazës për përcaktimin e caqeve të ardhshme përmes zhvillimit gradual të të dhënave më të qëndrueshme për trendet historike.

2.1.1. Harta e aktiviteteve të OZHQ-së

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Kombeve të Bashkuara ofrojnë një kornizë të njohur ndërkombëtarisht për trajtimin e sfidave të rëndësishme ekonomike, sociale dhe mjedisore. Për KEP Trust, ato shërbejnë si referencë e dobishme për ndërlidhjen e prioriteteve institucionale me objektivat më të gjera të qëndrueshmërisë.

Në këtë raport, OZHQ-të paraqiten jo si një vlerësim i ri i veçantë, por si vazhdimësi e bazës së qëndrueshmërisë së krijuar në ciklin paraprak të raportimit. Ato mbeten relevante si një kornizë e gjerë udhëzuese, ndërsa KEP Trust vazhdon të avancojë veprime, të forcojë sisteme dhe të ndërtojë progres praktik në fushat e tij prioritare.

Në përputhje me këtë, OZHQ-të e mëposhtme vazhdojnë të pasqyrojnë fushat më të lidhura ngushtë me misionin, operacionet, angazhimin e palëve të interesit dhe drejtimin e qëndrueshmërisë së KEP Trust.

OZHQ 5: Barazia gjinore. KEP Trust është i përkushtuar të promovojë barazinë gjinore si pjesë të rëndësishme të zhvillimit gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm. Ky përkushtim pasqyrohet si në aspektin e jashtëm, ashtu edhe në atë të brendshëm. Përmes bashkëpunimit me partnerë të shumtë financues dhe nisma financimi të orientuara drejt ndikimit, KEP Trust vazhdon të mbështesë qasjen në financa për

bizneset dhe ekonomitë familjare të udhëhequra nga gratë, duke ndihmuar në zgjerimin e mundësive ekonomike dhe përfshirjes financiare. Në të njëjtën kohë, institucioni ka forcuar kornizën e tij të brendshme përmes politikave dhe praktikave që mbështesin mundësitë e barabarta, dinjitetin, mbrojtjen dhe trajtimin me respekt në vendin e punës, duke përforcuar barazinë gjinore si prioritet social dhe institucional.

OZHQ 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike. Gjatë periudhës së raportimit 2024–2025, KEP Trust vazhdoi të mbështesë rritjen e qëndrueshme ekonomike duke zgjeruar qasjen në financa për ekonomitë familjare, ndërmarrësit, fermerët dhe bizneset e vogla dhe të mesme në mbarë Kosovën. Kjo pasqyrohet në rritjen e vazhdueshme të portofolit, nga 116.09 milionë € në vitin 2024 në 139.69 milionë € në vitin 2025, dhe në përbërjen e portofolit, ku kredithënia për biznes, banim, NVM dhe bujqësi mbetet ndër kategoritë më të rëndësishme. Përmes këtij aktiviteti financimi, KEP Trust kontribuon në vazhdimësinë e biznesit, investimet lokale, gjenerimin e të ardhurave dhe qëndrueshmërinë ekonomike, ndërsa veprimet në përmirësimin e proceseve dhe zhvillimin e stafit mbështesin më tej aftësinë e institucionit për t'iu përgjigjur nevojave të klientëve dhe tregut.

OZHQ 10: Zvogëlimi i pabarazive. Gjithëpërfshirja mbetet pjesë thelbësore e vlerave dhe qasjes operacionale të KEP Trust. Duke promovuar qasje të barabartë në shërbime financiare dhe duke ruajtur praktika të brendshme që mbështesin diversitetin, drejtësinë dhe mos diskriminimin, KEP Trust kontribuon në zvogëlimin e pabarazive sociale dhe ekonomike dhe në zgjerimin e mundësive për grupet me qasje të pamjaftueshme. Ky përkushtim është forcuar më tej përmes miratimit të Politikës për të Drejtat e Njeriut, e cila forcon kornizën më të gjerë të institucionit për dinjitet, barazi dhe respekt në marrëdhëniet e tij me punonjësit, klientët dhe palët e tjera të interesit.

OZHQ 11: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme. Përmes rrjetit të gjerë të degëve dhe zgjerimit të vazhdueshëm të aktivitetit të financimit, KEP Trust kontribuon në komunitete më të fuqishme dhe më reziliente në mbarë Kosovën. Duke ofruar qasje në financa për ekonomitë familjare, ndërmarrësit lokalë, fermerët dhe bizneset e vogla si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale, institucioni mbështet pjesëmarrjen ekonomike lokale, stabilitetin e komunitetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Në këtë mënyrë, rritja e KEP Trust lidhet ngushtë me zhvillimin më të gjerë të komunitetit dhe përfshirjen financiare.

OZHQ 13: Veprimi klimatik. Gjatë periudhës së raportimit 2024–2025, KEP Trust forcoi matjen dhe raportimin e lidhur me klimën përmes një inventari të përditësuar të gazrave serrë që mbulon si emetimet operacionale, ashtu edhe aktivitetet e financuara. Duke u mbështetur në bazën e vitit 2023, institucioni vlerësoi emetimet e Fushës 1, Fushës 2 dhe Fushës 3 dhe zgjeroi analizën e tij për të përfshirë emetimet e portofolit. Gjetjet tregojnë përmirësim të vazhdueshëm në emetimet operacionale, ndërsa emetimet e financuara mbeten shtytësi kryesor i rritjes së emetimeve totale. Kjo e ka forcuar më tej fokusin e KEP Trust në matjen e emetimeve dhe menaxhimin e rrezikut mjedisor.

OZHQ 16: Paqe, drejtësi dhe institucione të forta. Në kontekstin e sotëm, KEP Trust vazhdon të përforcojë rëndësinë e institucioneve të forta përmes qeverisjes transparente, sjelljes etike, sistemeve të kontrollit të brendshëm, praktikave të pajtueshmërisë dhe llogaridhënies ndaj palëve të interesit. Ndërsa institucioni rritet dhe integron më tej qëndrueshmërinë në operacionet e tij, këto elemente mbeten

thelbësore për ruajtjen e besimit, mbështetjen e vendimmarrjes së përgjegjshme dhe forcimin e qëndrueshmërisë institucionale afatgjatë.

KEP Trust SDG Summary



Access to finance for women-led businesses and households



Financing for households, entrepreneurs, farmers and SMEs



Financial inclusion and Human Rights Policy



Community resilience through branch network and finance outreach



GHG inventory and environmental risk management



Governance, compliance and accountability

2.2. Vazhdimi i ndërtimit nga baza ekzistuese e qëndrueshmërisë

Raporti i parë i Qëndrueshmërisë i KEP Trust krijoi bazën fillestare për identifikimin dhe strukturimin e prioriteteve kyçe të qëndrueshmërisë së institucionit. Këto prioritete u formësuan përmes analizës së informuar nga palët e interesit dhe ofruan një pikënisje të rëndësishme për të kuptuar çështjet që konsiderohen më relevante për operacionet, përgjegjësitë dhe ndikimin më të gjerë të KEP Trust.

Gjatë periudhës së raportimit 2024–2025, KEP Trust nuk zhvilloi një analizë të re formale të materialitetit. Në vend të kësaj, institucioni vazhdoi të mbështetet në bazën e qëndrueshmërisë dhe fushat prioritare tashmë të përcaktuara në raportin paraprak, pasi shumë prej veprimeve, sistemeve dhe zhvillimeve institucionale të lidhura me to mbetën në proces dhe kërkonin zbatim, forcim dhe ndjekje të mëtejshme. Në këtë kontekst, fokusi i raportimit është vendosur në ndërtimin e përvojës praktike, avancimin e veprimeve konkrete, përmirësimin e sistemeve të brendshme dhe konsolidimin e progresit në fushat prioritare tashmë të identifikuara.

Megjithëse nuk u ndërmor një rivlerësim formal, perspektivat e palëve të interesit vazhduan të ndikojnë në punën e KEP Trust për qëndrueshmëri përmes angazhimit të vazhdueshëm me punonjësit, klientët, partnerët, financuesit dhe organizatat ndërkombëtare. Këto ndërveprime, së bashku me përvojën operacionale të institucionit, projektet në vazhdim e sipër dhe praktikatat në zhvillim të qëndrueshmërisë,

kanë ndihmuar në konfirmimin e relevancës së vazhdueshme të fushave ekzistuese prioritare, duke formësuar njëkohësisht mënyrën se si ato po trajtohen në praktikë.

Në përputhje me këtë, ky raport i kushton theks më të madh veprimeve të avancuara, sistemeve të forcuara dhe progresit të arritur gjatë periudhës së raportimit, në vend se të përsërisë procesin fillestar të vlerësimit. Seksionet e mëposhtme, rrjedhimisht, pasqyrojnë se si KEP Trust ka vazhduar të ndërtojë mbi bazën ekzistuese të qëndrueshmërisë përmes zbatimit, të mësuarit institucional dhe integritit gradual të qëndrueshmërisë në operacionet dhe vendimmarrjen e tij.

Si pjesë e këtij zhvillimi të vazhdueshëm, KEP Trust ka kontraktuar një auditim/vlerësim të jashtëm zyrtar të Treguesve të Performancës Sociale (TPS). Procesi do të ofrojë një pasqyrë të përditësuar të performancës sociale të institucionit dhe do të krijojë një bazë më të qartë për veprimet e ardhshme, duke mbështetur identifikimin e pikave të forta, boshllëqeve dhe prioritetëve për përmirësim.



3. Qeverisja Korporative

3.1. Parimet dhe politikat e qeverisjes korporative, Parimet etike

Qasja e qeverisjes korporative e KEP Trust pasqyron përkushtimin e tij të vazhdueshëm për ruajtjen e standardeve të larta të qeverisjes, integritetit dhe sjelljes etike. Këto parime mbeten themelore për ndërtimin e besimit të palëve të interesit, mbështetjen e vendimmarrjes së shëndoshë dhe sigurimin e zhvillimit institucional të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm. Në kontekstin e sotëm, korniza e qeverisjes së KEP Trust vazhdon të theksojë transparencën, llogaridhënien, drejtësinë dhe pajtueshmërinë, duke

ofruar bazën si për mbikëqyrjen strategjike, ashtu edhe për menaxhimin e përgjegjshëm të operacioneve të përditshme.

KEP Trust Corporate Governance Principles



KEP Trust ka krijuar një grup gjithëpërfshirës të dokumenteve të brendshme për të garantuar zbatimin efektiv të parimeve të qeverisjes korporative. Disa nga politikat kyçe përfshijnë:

- Politika e Burimeve Njerëzore
- Kodi i sjelljes
- Politika për të Drejtat e Njeriut
- Politika për Dhunën me Bazë Gjinore dhe Kundër Ngacmimit
- Politika e prokurimit
- Politika për rrezikun kreditor
- Politika e menaxhimit të rrezikut
- Politika e rrezikut operativ
- Politika e kontrollit të brendshëm
- Politika për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale
- Procedurat e parandalimit të mashtrimit, ryshfetit, korrupsionit dhe sinjalizimit
- Politika për teknologjinë e informacionit

Këto politika rishikohen dhe përditësohen rregullisht për të mbetur të harmonizuara me kornizën e qeverisjes së KEP Trust, nevojat operationale dhe detyrimet ligjore. Së bashku, ato mbështesin vendimmarrjen e qëndrueshme, llogaridhënien institucionale dhe kulturën e integritetit. Përfshirja më e

fundit e Politikës për të Drejtat e Njeriut dhe Politikës për Dhunën me Bazë Gjinore dhe Kundër Ngacmimit e forcon më tej këtë kornizë duke përforcuar dinjitetin, respektin dhe mbrojtjen në marrëdhëniet e KEP Trust me punonjësit, klientët dhe palët e tjera të interesit.

Sjellja etike mbetet pjesë thelbësore e kulturës institucionale dhe operacioneve të përditshme të KEP Trust. Kodi i sjelljes përcakton standardet e pritura të sjelljes dhe ofron udhëzime për trajtimin e çështjeve etike në mënyrë të përputhshme me vlerat e institucionit. Ai shërben si pikë kyçe referimi në të gjitha nivelet e organizatës, dhe të gjithë punonjësit e konfirmojnë çdo vit kuptimin e tyre të Kodit.

Procedura disiplinore zbatohet për të gjithë punonjësit dhe ka për qëllim të sigurojë drejtësi, qëndrueshmëri dhe proces të rregullt në çështjet disiplinore. Ajo përcakton veprimet që mund të ndërmerren kur standardet profesionale ose rregullat e brendshme nuk përmbushen, duke qartësuar njëkohësisht të drejtat dhe përgjegjësitë e punonjësve. Në këtë mënyrë, ajo mbështet një kornizë transparente të vendit të punës dhe pajtueshmërinë me legjislacionin e aplikueshëm të punës në Kosovë.

3.2. Transparenca dhe raportimi

Transparenca, raportimi i brendshëm dhe pajtueshmëria mbeten elemente kyçe të kornizës së qeverisjes së KEP Trust. Së bashku, ato mbështesin llogaridhënien, forcojnë kontrollat e brendshme dhe ndihmojnë të sigurohet që praktikat institucionale të mbeten në përputhje me kërkesat ligjore, politikat e brendshme dhe pritjet e palëve të interesit.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm luan rol të rëndësishëm në rishikimin e politikave kyçe, mekanizmeve të kontrollit dhe proceseve operacionale. Duke përdorur një qasje auditimi të bazuar në rrezik, ai ndihmon në identifikimin e fushave për përmirësim, mbështet mbikëqyrje më të fuqishme dhe kontribuon në efektivitetin e mjedisit të kontrollit të brendshëm të KEP Trust.

Paralelisht me këtë, KEP Trust vazhdon të monitorojë kornizën ligjore dhe rregullative të aplikueshme në Kosovë dhe të ofrojë raportim të rregullt për menaxhmentin dhe strukturat përkatëse të mbikëqyrjes së rrezikut në nivel bordi. Përditësimet lidhur me legjislacionin e ri, zhvillimet rregullative dhe implikimet e pajtueshmërisë komunikohen brenda institucionit për të mbështetur reagimin me kohë dhe vendimmarrjen e informuar.

Politika Ligjore dhe e Pajtueshmërisë ofron kornizën për menaxhimin e detyrimeve ligjore dhe rregullative në të gjithë institucionin dhe ndihmon të sigurohet që operacionet të zhvillohen në përputhje me kërkesat e aplikueshme. Kjo kornizë plotësohet nga komunikimi dhe mbikëqyrja e rregullt e brendshme, duke mbështetur qëndrueshmërinë, vetëdijen ligjore dhe praktikën institucionale të përgjegjshme.

KEP Trust gjithashtu zbaton Politikën për Trajtimin e Ankesave, e cila u jep klientëve dhe palëve të tjera të interesit një mekanizëm të qartë për ngritjen e shqetësimeve. Kjo mbështet drejtësinë, reagimin e duhur dhe transparencën, duke e ndihmuar njëkohësisht institucionin të identifikojë çështjet, të forcojë cilësinë e shërbimit dhe të ruajë besimin e palëve të interesit.

Ndërsa KEP Trust vazhdon të forcojë qasjen e tij të qëndrueshmërisë, këta mekanizma të qeverisjes, raportimit dhe pajtueshmërisë ofrojnë gjithashtu një bazë më të fuqishme për integrimin e konsideratave të lidhura me MSQ-në në monitorimin e brendshëm, mbledhjen e të dhënave dhe raportimin institucional.

Në këtë mënyrë, transparenca dhe pajtueshmëria mbeten të lidhura ngushtë me zhvillimin e qeverisjes dhe llogaridhënies që lidhet me qëndrueshmërinë.

3.3. Qasja ndaj menaxhimit të rrezikut

Menaxhimi i rrezikut mbetet pjesë thelbësore e qëndrueshmërisë institucionale dhe vendimmarrjes së KEP Trust. Qasja e institucionit fokusohet në identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe monitorimin e rreziqeve në mënyrë të strukturuar dhe të qëndrueshme, me qëllim të mbrojtjes së operacioneve, mbështetjes së rritjes së përgjegjshme dhe ruajtjes së qëndrueshmërisë financiare dhe operacionale.

Korniza e menaxhimit të rrezikut të KEP Trust mbështetet nga politikat e brendshme, monitorimi i rregullt dhe koordinimi ndërmjet menaxhmentit dhe funksioneve përkatëse. Ajo mbulon fushat kryesore të ekspozimit të institucionit, duke përfshirë rrezikun kreditor, rrezikun operacional, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e financimit dhe rrezikun mjedisor e social. Kjo kornizë ndihmon të sigurohet që ekspozimi ndaj rrezikut të rishikohet vazhdimisht dhe të mbahet brenda kufijve të pranueshëm.

Rreziku kreditor mbetet një nga fushat më të rëndësishme të fokusit të institucionit. Ai menaxhohet përmes vlerësimit të huamarrësve, monitorimit të portofolit dhe vëmendjes së vazhdueshme ndaj cilësisë së kredive dhe performancës së shlyerjes. Kjo i ndihmon KEP Trust të ruajë një portofol të shëndoshë dhe të përgatitet në mënyrë adekuate për humbjet e mundshme nga kreditë.

Rreziku operacional menaxhohet përmes kontrolleve të brendshme, përfshirjes së stafit, mjeteve të monitorimit dhe përdorimit të treguesve kyç të rrezikut si sinjale të paralajmërimit të hershëm. Investimi i vazhdueshëm i KEP Trust në mjete digjitale dhe përmirësim të proceseve mbështet gjithashtu mbikëqyrje më të fuqishme, rrjedha pune më transparente dhe zbutje më efektive të çështjeve operacionale.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit fokusohet në ruajtjen e rrjedhave të mjaftueshme të parasë për të përmbushur detyrimet aktuale dhe të ardhshme. KEP Trust e mbështet këtë përmes monitorimit të rregullt të likuiditetit dhe testimit të stresit, ndërsa rreziqet e normës së interesit dhe financimit menaxhohen përmes mbikëqyrjes së bilancit të gjendjes, rishikimit të strukturës së financimit dhe analizës së boshllëkut të maturitetit. Duke qenë se asetet dhe detyrimet janë kryesisht të denominuara në euro, rreziku i këmbimit valutor mbetet i kufizuar.

Që nga viti 2021, KEP Trust ka zbatuar Sistemin e tij të Menaxhimit Social dhe Mjedisor (SMSM) si kornizë fillestare për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale në aktivitetet e kredidhënies. Kjo mundëson që vendimet financiare të rishikohen jo vetëm nga perspektiva financiare, por edhe në raport me ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale. Në të njëjtën kohë, institucioni pranon se një qasje më gjithëpërfshirëse e vlerësimit të rrezikut mjedisor dhe social ende duhet të zhvillohet më tej, veçanërisht në lidhje me portofolin më të gjerë dhe thellësinë e analizës së ekspozimit. Prandaj, KEP Trust vazhdon ta forcojë këtë fushë përmes të mësuarit të brendshëm, zhvillimit të kapaciteteve të stafit dhe përmirësimit gradual të praktikave të menaxhimit të rrezikut. Informacione të hollësishme për SMSM-në jepen në seksionet 2.1 dhe 5.2.



4. Përgjegjësia sociale

4.1. Vlera për shoqërinë

KEP Trust krijon vlerë për shoqërinë kryesisht përmes rolit të tij si institucion financiar i përgjegjshëm që mbështet ekonomitë familjare, ndërmarrësit, fermerët dhe bizneset e vogla në mbarë Kosovën. Kontributi i tij social pasqyrohet në financimin që ofron dhe në mënyrën se si promovon përfshirjen financiare, mbrojtjen e klientëve, kredithënien e përgjegjshme dhe mbështetjen e komunitetit. Me rritjen e institucionit, kjo vlerë është lidhur më ngushtë me mundësitë ekonomike dhe ndikimin më të gjerë social të operacioneve, partneriteteve dhe angazhimit me palët e interesit. Kjo përfshin rritjen e aktivitetit të kredithënies nga e cila përfitojnë gratë, si përmes mbështetjes për bizneset e udhëhequra nga gratë, ashtu edhe përmes financimit që kontribuon në stabilitetin e ekonomive familjare të udhëhequra nga gratë. Prandaj, qasja e KEP Trust ndaj përgjegjësisë sociale fokusohet në qëndrueshmërinë e komunitetit, zhvillimin gjithëpërfshirës dhe harmonizimin e rritjes institucionale me nevojat më të gjera sociale.

4.1.1. Produktet dhe shërbimet

KEP Trust ofron një gamë produktesh dhe shërbimesh financiare të dizajnuara për t'iu përgjigjur nevojave të ekonomive familjare, ndërmarrësve, fermerëve dhe bizneseve të vogla në mbarë Kosovën. Në vend që të fokusohet vetëm në llojllojshmërinë e produkteve, qasja e institucionit përqendrohet në rolin praktik që financimi luan në mbështetjen e përfshirjes financiare, gjenerimit të të ardhurave, vazhdimësisë së biznesit, qëndrueshmërisë së ekonomive familjare dhe zhvillimit ekonomik lokal.

Në këtë kontekst, aktiviteti i financimit i KEP Trust mund të kuptohet përmes disa fushave të gjera të mbështetjes, duke përfshirë financimin e biznesit dhe ndërmarrësisë, financimin e banimit dhe ekonomive familjare, financimin bujqësor dhe zgjidhjet e thjeshtuara të kredidhënies me qasje të shpejtë. Së bashku, këto kategori financimi ndihmojnë në trajtimin e nevojave të ndryshme të klientëve dhe situatave jetësore apo të biznesit, duke mbështetur njëkohësisht pjesëmarrjen më të gjerë sociale dhe ekonomike në komunitetet urbane dhe rurale.

Gjatë periudhës së raportimit 2024–2025, ky rol u pasqyrua në rritjen e vazhdueshme të portofolit dhe aktivitetin e fuqishëm në segmentet kyçe të kredidhënies, duke përfshirë biznesin, banimin, NVM-të dhe bujqësinë. Rritja e aktivitetit të kredidhënies nga e cila përfitojnë gratë, si përmes mbështetjes për bizneset e udhëhequra nga gratë, ashtu edhe për ekonomitë familjare të udhëhequra nga gratë, gjithashtu ishte pjesë e këtij kontributi. Në këtë mënyrë, produktet dhe shërbimet e KEP Trust vazhdojnë të gjenerojnë vlerë sociale duke zgjeruar qasjen në financa, duke mbështetur qëndrueshmërinë dhe duke kontribuar në zhvillim ekonomik më gjithëpërfshirës.

4.1.2. Gjithëpërfshirja financiare

Gjithëpërfshirja financiare është thelbësore për misionin e KEP Trust si institucion mikrofinanciar. Duke ofruar qasje në shërbime financiare për individët me të ardhura të ulëta, ekonomitë familjare, fermerët dhe bizneset e vogla, KEP Trust mbështet mundësitë ekonomike dhe zhvillimin lokal. Kjo qasje i ndihmon klientët të forcojnë pavarësinë e tyre financiare dhe kontribuon në mirëqenien më të gjerë të komunitetit.

KEP Trust gjithashtu mbështet edukimin financiar përmes përmbajtjes edukative dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit për klientët ekzistues dhe potencialë. Këto mund të përfshijnë artikuj, video, punëtori, uebinarë dhe seminare që i ndihmojnë klientët të kuptojnë më mirë produktet financiare, përgjegjësitë dhe vendimmarrjen. Kjo mbështet përfshirjen financiare të përgjegjshme dhe i ndihmon klientët të përdorin shërbimet financiare në mënyrë më efektive.

4.1.3. Mbrojtja e klientëve

Mbrojtja e klientëve është pjesë thelbësore e punës së KEP Trust si institucion mikrofinanciar. Institucioni fokusohet në ofrimin e shërbimeve financiare që janë të drejta, transparente dhe të besueshme, duke siguruar njëkohësisht që klientët të trajtohen me respekt dhe që të drejtat e tyre të mbrohen.

Parimet e mbrojtjes së klientëve janë pjesë e kulturës organizative të KEP Trust dhe mbështesin përkushtimin e tij ndaj kredidhënies së përgjegjshme, vendimmarrjes së informuar dhe pavarësisë ekonomike të klientëve të tij.

Përkushtimi i KEP Trust ndaj mbrojtjes së klientëve është njohur gjithashtu nga jashtë përmes certifikimeve dhe çmimeve sektoriale që lidhen me ofrimin etik të shërbimeve dhe trajtimin e përgjegjshëm të klientëve.

KEP Trust ka pranuar Certifikimin për Mbrojtjen e Klientëve nga MFR Certification, duke arritur nivelin Gold në mbrojtjen e klientëve. Ky nivel pasqyron pajtueshmëri të fuqishme me standardet e mbrojtjes së klientëve dhe praktikë të mirë të njohur në menaxhimin e performancës sociale dhe mjedisore.

Këto certifikime konfirmojnë përkushtimin e KEP Trust për mbrojtjen e klientëve dhe ruajtjen e praktikave të përgjegjshme. Ato gjithashtu mbështesin përpjekjet e vazhdueshme të institucionit për të përmirësuar cilësinë e shërbimit dhe trajtimin e drejtë në të gjitha operacionet e tij.

4.1.4. Qasja ndaj përgjegjësisë sociale korporative

Qasja e KEP Trust ndaj përgjegjësisë sociale korporative vazhdon të fokusohet në mbështetjen e nismave që kontribuojnë në mirëqenien e komunitetit, përfshirjen dhe zhvillimin lokal në mbarë Kosovën. Gjatë periudhës së raportimit, kjo mbështetje u pasqyrua përmes kontributeve të përzgjedhura financiare, sponsorizimeve dhe bashkëpunimeve në fusha si arsimi, kultura, sporti, bujqësia, përfshirja sociale dhe nismat me bazë në komunitet.

Në vend që të kufizohet në një fushë të vetme, mbështetja e KEP Trust për komunitetin është drejtuar kah një gamë e gjerë nismash me relevancë sociale dhe lokale. Këto kanë përfshirë mbështetjen për aktivitete kulturore dhe arsimore, zhvillim bujqësor, nisma për të rinj dhe sport, organizata që punojnë me persona me aftësi të kufizuara, aktivitete të lidhura me bursa dhe trajnime, si dhe raste të përzgjedhura të ndihmës së drejtpërdrejtë për komunitetet. Përmes kësaj qasjeje, KEP Trust synon të harmonizojë kontributin e tij social me vlerat institucionale, duke iu përgjigjur njëkohësisht nevojave praktike të komunitetit në mënyrë të matur dhe të përgjegjshme.

Ky kontribut ka mbështetur gjithashtu fusha që pasqyrojnë prioritetet më të gjera sociale të KEP Trust, duke përfshirë përfshirjen, mundësitë dhe qasjen për grupet e nën-përfaqësuar ose të cenueshme. Në këtë mënyrë, sponsorizimet dhe mbështetja e komunitetit vazhdojnë të jenë pjesë e qasjes më të gjerë të përgjegjësisë sociale të institucionit, duke mbetur plotësuese ndaj rolit të tij kryesor si institucion financiar i përgjegjshëm.

Krahas aktiviteteve më të gjera të orientuara drejt komunitetit, KEP Trust ka ofruar gjithashtu mbështetje të përzgjedhur të drejtpërdrejtë financiare në raste të nevojës individuale ose familjare. Edhe pse një mbështetje e tillë nuk është fokusi kryesor i qasjes së institucionit ndaj PSK-së, ajo pasqyron një gatishmëri të vazhdueshme për t'iu përgjigjur, aty ku është e përshtatshme, rrethanave specifike sociale me ndjeshmëri dhe diskrecion.

4.1.5. Bashkëpunimet, donacionet dhe sponsorimet

Gjatë periudhës 2024–2025, KEP Trust vazhdoi të angazhohet në bashkëpunime, donacione dhe sponsorizime përmes një game kontributesh të drejtuara kah nismat për komunitete, kulturore, arsimore, bujqësore, sportive dhe të përfshirjes sociale. Mbështetja e ofruar gjatë kësaj periudhe pasqyron një qasje të gjerë, por selektive, duke kombinuar partneritete formale, sponsorizime të ngjarjeve, kontribute institucionale dhe ndihmë të synuar komunitare.

Community Support Areas 2024–2025




- mbështetje për ngjarje kulturore dhe të komuniteteve në nivel lokal dhe rajonal;
- kontribute për aktivitete arsimore, bursa dhe zhvillim të rinjve;
- bashkëpunim i vazhdueshëm me nisma të zhvillimit bujqësor dhe partneritete të ndërlidhura;
- sponsorizime në aktivitete sportive dhe pjesëmarrjeje në komunitet; dhe
- mbështetje për raste të përfshirjes sociale, të ndërlidhura me aftësinë e kufizuar, rehabilitimin dhe ndihmën individuale.

Përmes këtyre kontributeve, KEP Trust mbështet kohezionin social, pjesëmarrjen lokale, qëndrueshmërinë e komunitetit dhe qasjen në mundësi për grupe dhe rajone të ndryshme. Qasja e institucionit mbetet praktike dhe e matur, duke u fokusuar në mbështetje që shton vlerë për komunitetin dhe përshtatet me qasjen e tij më të gjerë ndaj përgjegjësisë sociale.

Në aspektin financiar, kontributet për komunitete të KEP Trust u rritën nga 199,292 € në vitin 2023 në 282,537 € në vitin 2024 dhe 350,926 € në vitin 2025, duke pasqyruar forcimin e vazhdueshëm të mbështetjes së tij për nismat sociale dhe të orientuara drejt komunitetit. Në vitin 2025, këto kontribute përfaqësuan përafërsisht 6% të tepricës neto të institucionit, duke nënvizuar rëndësinë praktike të mbështetjes së komunitetit brenda qasjes më të gjerë të përgjegjësisë sociale të KEP Trust.

Së bashku, këto kontribute tregojnë një model të gjerë por të fokusuar të mbështetjes së komunitetit gjatë periudhës së raportimit, duke kombinuar relevancën lokale me objektivat më të gjera të përgjegjësisë sociale të KEP Trust.

Community Contributions Growth (2023–2025)



4.2. Vlera për punonjësit

Në KEP Trust, punonjësit konsiderohen qendrorë për suksesin e organizatës. Institucioni punon për të ofruar një mjedis pune mbështetës dhe respektues që promovon zhvillimin profesional, mirëqenien personale, dinjitetin, mundësitë e barabarta dhe një kulturë të shëndetshme të vendit të punës. Këto prioritetë janë në përputhje me analizën e materialitetit, ku Mirëqenia e Punonjësve, Mjedisi i Shëndetshëm i Punës dhe Zhvillimi i Punonjësve u identifikuan si fusha të rëndësishme për palët e brendshme dhe të jashtme të interesit.

Paketa e përfitimeve e KEP Trust mbështet punonjësit si në rrethana profesionale, ashtu edhe personale. Ajo përfshin sigurim shëndetësor, jetësor dhe të invaliditetit, bonuse të performancës dhe të fundvitit, mundësi për zhvillim të vazhdueshëm profesional, pushim personal për provimet universitare, aranzhime fleksibile të punës, kompensim për automjet, mbulim të shpenzimeve të telefonit dhe mundësinë e marrjes së një page paraprakisht me shlyerje në këste. Mbështetje shtesë ofrohet gjithashtu për nënat me fëmijë deri në tre vjeç, prindërit vetushqyes, sëmundjen ose kujdesin për të afërmit e sëmurë.

4.2.1. Profili i punonjësit


Profili i punonjësve të KEP Trust pasqyron një fuqi punëtore të qëndrueshme dhe përgjithësisht të balancuar, e cila mbështet operacionet në Zyrën Qendrore dhe rrjetin e degëve. Gjatë periudhës së raportimit 2024–2025, numri i punonjësve u rrit nga 265 në 275, në përputhje me rritjen e portofolit dhe zhvillimin operacional. Fuqia punëtore mbeti e balancuar në aspektin gjinor, ku gratë përfaqësonin pak më shumë se gjysmën e stafit total në të dy vitet e raportimit.

Një pjesë e konsiderueshme e punonjësve vazhdoi të punojë në operacionet e kredive dhe të zyrës për shërbim të klientëve, duke pasqyruar modelin e KEP Trust të orientuar drejt klientit dhe praninë e gjerë në mbarë Kosovën. Në nivel qeverisjeje, Bordi Menaxhues mbeti i përbërë nga katër anëtarë, ndërsa përbërja e tij gjinore ndryshoi nga tre burra dhe një grua në vitin 2024 në dy burra dhe dy gra në vitin

2025. Largimet e stafit u ulën nga 19 në vitin 2024 në 16 në vitin 2025, duke treguar një fuqi punëtore më të qëndrueshme gjatë periudhës së raportimit.

Zhvillimi i punonjësve gjithashtu u forcua gjatë periudhës, me orët totale të trajnimit që arritën në 4,156 sosh në vitin 2025 dhe pothuajse të gjithë stafin që mori pjesë në të paktën një aktivitet trajnimi të brendshëm ose të jashtëm. Kjo u mbështet nga rritja e buxhetit vjetor të trajnimit, nga 50,000 € në vitin 2024 në 72,000 € në vitin 2025, duke pasqyruar investimin e vazhdueshëm të KEP Trust në kapacitetin e stafit dhe zhvillimin profesional.

Workforce Snapshot 2024–2025



4.2.2. Qasja ndaj burimeve njerëzore

Qasja e KEP Trust ndaj Burimeve njerëzore bazohet në parimet e dinjitetit, drejtësisë, përfshirjes, mundësive të barabarta dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Institucioni vazhdon të promovojë një mjedis pune ku rekrutimi, punësimi, zhvillimi dhe avancimi bazohen në meritë, shkathtësi, kualifikime dhe performancë profesionale, pa diskriminim në bazë të karakteristikave personale apo prejardhjes.

Për të forcuar më tej këtë përkushtim, KEP Trust ka prezantuar Politikën për dhunën me bazë gjinore dhe kundër ngacmimit dhe Politikën për të drejtat e njeriut si dokumente të veçanta. Këto politika përforcojnë rëndësinë që KEP Trust i kushton dinjitetit, sigurisë, barazisë, mosdiskriminimit, mbrojtjes nga ngacmimi dhe trajtimit të përgjegjshëm të të gjithë individëve. Në të njëjtën kohë, ato plotësojnë grupin më të gjerë të politikave të Burimeve njerëzore duke ofruar udhëzime, përgjegjësi dhe pritje më të qarta në fusha që janë thelbësore për një kulturë të vendit të punës respektuese dhe llogaridhënëse.

KEP Trust mban një qasje të tolerancës zero ndaj diskriminimit, ngacmimit, dhunës me bazë gjinore, sjelljes abuzive ose çdo sjelljeje që cenon dinjitetin e një personi apo krijon një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues ose fytes. Kjo qasje zbatohet për punonjësit dhe për të gjithë individët që ndërveprojnë me institucionin, duke përfshirë klientët, furnizuesit, kontraktorët, partnerët dhe palët e tjera të interesit. Përmes Politikës së veçantë për Dhunën me Bazë Gjinore dhe Kundër Ngacmimit, KEP

Trust qartëson më tej pritjet për parandalimin, raportimin, reagimin dhe llogaridhënien në lidhje me një sjellje të tillë.

Konsideratat për të drejtat e njeriut pasqyrohen gjithashtu në praktikat e punësimit të KEP Trust dhe përgjegjësitë më të gjera institucionale. Politika për të drejtat e njeriut ofron një kornizë të dedikuar për përforcimin e respektimit të të drejtave themelore, praktikave të drejta të punës, kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës, mosdiskriminimit dhe mbrojtjes nga puna e fëmijëve dhe puna e detyruar. Ajo gjithashtu mbështet përkushtimin e institucionit ndaj lirisë së asociimit dhe sjelljes së përgjegjshme në marrëdhëniet e tij me punonjësit, klientët, komunitetet dhe palët e tjera të interesit.

Punësimi i personave me aftësi të kufizuara trajtohet në përputhje me politikat e Burimeve Njerëzore të KEP Trust dhe legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë. Kjo pasqyron përkushtimin më të gjerë të institucionit ndaj mundësive të barabarta, përfshirjes dhe respektimit të dinjitetit të personave me aftësi të kufizuara në vendin e punës.

KEP Trust gjithashtu ofron mekanizma të qasshëm të ankesave dhe raportimit, përmes të cilëve punonjësit dhe palët përkatëse të interesit mund të ngrenë shqetësime lidhur me diskriminimin, ngacmimin, shkeljet e të drejtave të njeriut ose sjellje të tjera të papërshtatshme. Këta mekanizma mbështesin identifikimin e hershëm të shqetësimeve, ndjekjen e duhur dhe forcimin e vazhdueshëm të një mjedisi pune respektues, të sigurt dhe të bazuar në të drejta.

4.2.2.1. Menaxhimi i performancës, ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi

Zhvillimi i punonjësve mbetet kritik për qëndrueshmërinë e operacioneve të KEP Trust dhe ofrimin efektiv të shërbimeve. Në periudhën aktuale të raportimit, zhvillimi i kapaciteteve vazhdon të mbështesë si performancën institucionale, ashtu edhe cilësinë e shërbimit, duke forcuar kompetencat e stafit, duke përforcuar standardet profesionale dhe duke ndihmuar punonjësit të përshtaten me kërkesat në zhvillim operative, rregullative, digjitale dhe të shërbimit ndaj klientëve.

Menaxhimi i performancës kryhet të paktën një herë në vit dhe mbetet një mjet i rëndësishëm për mbështetjen e efikasitetit individual, zhvillimit profesional dhe harmonizimit me objektivat institucionale. Vlerësimi i performancës kryhet gjithashtu kur një punonjës përfundon periudhën provuese, avancohet ose transferohet në një pozitë tjetër. Departamenti i Burimeve Njerëzore e koordinon procesin duke informuar punonjësit, duke shpërndarë formularët e vlerësimit të performancës tek mbikëqyrësit dhe duke komunikuar afatet e aplikueshme.

Vlerësimi i performancës pritet të jetë i qartë, konstruktiv dhe i dobishëm për identifikimin e nevojave për zhvillim. Rezultatet ndihmojnë në informimin e planeve të zhvillimit profesional dhe trajnimit, duke përfshirë objektivat specifike, orientimin e karrierës dhe fushat ku mund të kërkohet mbështetje, mentorim ose zhvillim shtesë i shkathtësive.

Trajnimi mbështet objektivat strategjike të KEP Trust dhe mbetet një proces i vazhdueshëm. Gjatë viteve 2024–2025, programet e trajnimit vazhduan të mbulojnë gjerësisht të njëjtat fusha si në periudhën paraprake, duke përfshirë certifikimin, MSQ-në, analizën e të dhënave, sigurinë e informacionit dhe

kibernetike, mbrojtjen e të dhënave, shërbimin ndaj klientëve, pajtueshmërinë, NJKT-në dhe fusha të tjera operacionale dhe të shkathtësive të buta relevante për modelin e biznesit të KEP Trust.

Buxheti vjetor i trajnimit u rrit nga 50,000 € në vitin 2024 në 72,000 € në vitin 2025, një rritje prej 22,000 €, ose përafërsisht 44% nga viti në vit. Kjo pasqyron investimin e vazhdueshëm të KEP Trust në kapacitetin e stafit, zhvillimin profesional dhe gatishmërinë për t'iu përgjigjur nevojave në ndryshim të tregut, rregullative, digjitale dhe të shërbimit ndaj klientëve.

Në vitin 2025, orët totale të trajnimit arritën në 4,156 sosh, me pothuajse të gjithë stafin që mori pjesë në të paktën një aktivitet trajnimi të brendshëm ose të jashtëm. Së bashku me buxhetin e rritur, kjo konfirmon se zhvillimi i punonjësve mbetet prioritet aktiv për KEP Trust. Vazhdimësia e fushave të trajnimit gjithashtu mbështet qëndrueshmërinë, ndërsa alokimi më i lartë krijon më shumë hapësirë për të forcuar programet ekzistuese dhe për t'iu përgjigjur nevojave të reja institucionale.



5. Përgjegjësia mjedisore

KEP Trust e njih përgjegjësinë mjedisore si pjesë të rëndësishme të qasjes së tij të qëndrueshmërisë. Institucioni fokusohet në menaxhimin e gjurmës së vet operacionale, duke mbështetur njëkohësisht ndërgjegjësimin mjedisor dhe praktikën e përgjegjshme të financimit përmes aktiviteteve të tij.

Korniza rregullative mjedisore dhe e lidhur me qëndrueshmërinë në Kosovë ka vazhduar të zhvillohet, duke forcuar bazën për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e burimeve dhe kalimin drejt energjisë më të pastër. Në vitin 2024, u miratua Ligji për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë, duke mbështetur përdorimin e shtuar të energjisë së ripërtërishme, sigurinë e përmirësuar energjetike dhe harmonizimin me objektivat e Kosovës për tranzicionin drejt energjisë së pastër.

5.1. Gjurma mjedisore

Gjurma mjedisore e KEP Trust lidhet kryesisht me operacionet e zyrave, rrjetin e degëve, parkun e automjeteve dhe konsumin e burimeve. Edhe pse institucionet financiare nuk janë shumë intensive në përdorimin e burimeve, KEP Trust monitoron energjinë elektrike, ujin, karburantin, letrën, materialet e printimit dhe ndikimet përkatëse operacionale. Institucioni gjithashtu vazhdon të promovojë ndërgjegjësimin mjedisor tek stafi dhe klientët, duke përfshirë përmes aktiviteteve këshilluese dhe trajnimeve që mbështesin praktika më të qëndrueshme.

- Përmes AgroDev, KEP Trust vazhdon të mbështesë një grup më të gjerë fermerësh përtej bazës së vet të klientëve, duke përfshirë përmes sesioneve këshilluese të organizuara në bashkëpunim me Departamentin e Bujqësisë dhe profesorët e fakultetit të bujqësisë në degë të përzgjedhura.
- KEP Trust ka vazhduar të rinovojë parkun e automjeteve me makina më efikase dhe më miqësore ndaj mjedisit, duke përfshirë disa automjete plotësisht elektrike. Këto përpjekje ndihmojnë në uljen e konsumit të karburantit dhe emetimeve përkatëse të CO₂ në departamentet relevante.
- KEP Trust monitoron konsumin e energjisë elektrike, ujit, letrës, materialeve të printimit dhe karburantit të parkut të automjeteve në të gjitha lokacionet, ndërsa Departamenti i administratës mbikëqyr të dhënat kyçe mjedisore operationale dhe nismat përkatëse të efikasitetit.
- Përmirësimet e fundit në pajisjet e ngrohjes dhe ftohjes, duke përfshirë zëvendësimin e sistemeve të vjetruara të klimatizimit me sisteme moderne të ndara me efikasitet energjetik, tashmë kanë filluar të japin rezultate pozitive në efikasitetin energjetik nëpër degë.

5.2. Vlerësimi i rrezikut mjedisor dhe social në aktivitetet e kredidhënies

KEP Trust vazhdon të zbatojë kornizën e tij SMSM në përputhje me IFC-në në aktivitetet e kredidhënies. Procesi përfshin një Listë Përrjashtuese të aktivitetëve që nuk janë të pranueshme për financim dhe zbatohet për të gjitha aplikacionet për kredi, pa prag. Gjatë vlerësimit, zyrtari kreditor verifikon nëse aktiviteti bie nën Listën përjashtuese, e kategorizon projektin si me rrezik të ulët, të mesëm ose të lartë dhe vlerëson treguesit e mundshëm të rrezikut mjedisor dhe social dhe pajtueshmërinë rregullative përmes një rishikimi në zyrë ose vizite në terren, varësisht nga kompleksiteti i projektit. Vlerësimi dokumentohet përmes Formularit të vlerësimit M&S, ndërsa rastet me rrezik më të lartë kërkojnë monitorim të vazhdueshëm nga Zyrtari i MSQ-së dhe, kur është e nevojshme, zhvillimin dhe zbatimin e një plani veprimi për zbutjen e rreziqeve të identifikuara. KEP Trust gjithashtu vazhdon të punojë drejt një rivlerësimi më gjithëpërfshirës të ekspozimeve kreditore të papaguara dhe rreziqeve M&S në nivel portofoli për të forcuar më tej vlerësimin dhe monitorimin e rrezikut.

5.3. Ndryshimet klimatike dhe menaxhimi mjedisor

Ndryshimet klimatike janë relevante për institucionet financiare sepse operationet dhe vendimet e financimit mund të ndikojnë në rezultatet mjedisore. KEP Trust monitoron përdorimin e energjisë elektrike, ujit, letrës, materialeve të printimit dhe karburantit të parkut të automjeteve në të gjitha lokacionet. Veprimet aktuale fokusohen në përmirësimin e efikasitetit energjetik, duke përfshirë përmirësimet e vazhdueshme të pajisjeve të ngrohjes dhe ftohjes dhe uljen e përdorimit të letrës aty ku është e mundur.

Puna mjedisore e KEP Trust fokusohet në zvogëlimin e gjurmës së vet operationale dhe integrimin gradual të konsideratave mjedisore në operatione dhe praktikë të kredidhënies. Në të ardhmen, institucioni planifikon të përmirësojë të dhënat mjedisore, të vendosë caqe praktike dhe të zhvillojë më tej një Sistem operacional të Menaxhimit Mjedor për të mbështetur monitorimin, raportimin dhe menaxhimin e rrezikut.

Si pjesë e përkushtimit të vazhdueshëm të KEP Trust ndaj qëndrueshmërisë dhe transparencës mjedisore, institucioni ka përgatitur një inventar të brendshëm të gazrave serrë që mbulon si emetimet operationale,

ashtu edhe aktivitetet e financuara. Vlerësimi është zhvilluar nga KEP Trust duke u bazuar në të dhënat e disponueshme të aktiviteteve, supozimet metodologjike dhe referencat e njohura të llogaritjes së gazrave serrë. Rezultatet, metodologjia dhe analiza e trendeve në mënyrë më të detajuar paraqiten në Raportin dyvjeçar të emetimeve të GHG të KEP Trust për vitet 2024–2025, i cili ofron një pasqyrë të dedikuar të performancës së gjurmës së karbonit të institucionit.

Për periudhën e raportimit 2024–2025, emetimet operacionale të gazrave serrë të KEP Trust tregojnë përmirësim gradual në fushat kryesore operacionale. Emetimet e drejtpërdrejta të Fushës 1 u ulën lehtë nga 167.72 tCO₂e në vitin 2024 në 166.43 tCO₂e në vitin 2025. Emetimet e Fushës 2 të lidhura me energjinë elektrike u ulën nga 671.88 tCO₂e në 662.67 tCO₂e, ndërsa emetimet e Fushës 3, duke përfshirë aktivitetet e financuara, u ulën nga 162.91 tCO₂e në 152.61 tCO₂e. Emetimet e përgjithshme operacionale ranë nga 1,002.51 tCO₂e në vitin 2024 në 981.71 tCO₂e në vitin 2025. Paralelisht, KEP Trust ka filluar të paraqesë emetimet e portofolit si pjesë e praktikës së tij raportuese në zhvillim. Në terma absolutë, emetimet e financuara u rritën nga 44,327.50 tCO₂e në vitin 2024 në 54,323.92 tCO₂e në vitin 2025, kryesisht duke pasqyruar rritjen e portofolit të kredidhënies nga 116.09 milionë € në 139.69 milionë €. Megjithatë, kjo rritje mbetet relativisht e kontrolluar kur shihet përmes intensitetit: emetimet për 1 milion € të financuar u rritën vetëm mesatarisht, nga 381.83 në 388.89 tCO₂e, ose rreth 1.8%. Kjo sugjeron se, ndërsa emetimet totale të financuara u rritën me zgjerimin e portofolit, emetimet e gjeneruara për njësi financimi ndryshuan vetëm pak, duke treguar një marrëdhënie gjerësisht të qëndrueshme ndërmjet rritjes së portofolit dhe intensitetit të emetimeve.

Pasqyra e emetimeve të GHG 2024–2025				
Emetimet operacionale	Fusha 1	Fusha 2	Fusha 3*	Intensiteti i portofolit
2024	2024	2024	2024	2024
1,002.51 tCO ₂ e	167.72 tCO ₂ e	671.88 tCO ₂ e	162.91 tCO ₂ e	381.83
2025	2025	2025	2025	tCO ₂ e / €1 milion i financuar
981.71 tCO ₂ e	166.43 tCO ₂ e	662.67 tCO ₂ e	152.61 tCO ₂ e	2025
Trendi: ↓ -2.1%	Trendi: ↓ -0.8%	Trendi: ↓ -1.4%	Trendi: ↓ -6.3%	388.89
				Trendi: ↑ +1.8%

*Fusha 3 përfshijë emetimet e financuara nga portofoli. Emetimet e portofolit paraqiten ndaras si intensitet, të shprehura si tCO₂e për 1 milion € të financuar, si pjesë e praktikës së brendshme të raportimit të GHG të KEP Trust. Rezultatet dhe metodologjia e detajuar janë të disponueshme në Raportin dyvjeçar të emetimeve të GHG të KEP Trust për vitet 2024–2025.



Deklarata përmbyllëse

Ky Raport dyvjeçar i qëndrueshmërisë pasqyron përpjekjet e vazhdueshme të KEP Trust për të forcuar financat e përgjegjshme, ndikimin social, qeverisjen e mirë dhe menaxhimin mjedisor gjatë periudhës së raportimit 2024–2025. Progresi i paraqitur në këtë raport tregon se qëndrueshmëria po integrohet më shumë në operacionet e institucionit, praktikat e kredithënies, zhvillimin e punonjësve, angazhimin e komunitetit dhe monitorimin mjedisor.

Në të njëjtën kohë, KEP Trust pranon se menaxhimi dhe raportimi i qëndrueshmërisë janë fusha në zhvillim që kërkojnë përmirësim të vazhdueshëm, të dhëna më të fuqishme, caqe më të qarta dhe angazhim të rregullt me palët e interesit. Institucioni do të vazhdojë të ndërtojë mbi progresin e arritur deri më tani duke përmirësuar sistemet e brendshme, duke forcuar menaxhimin e rrezikut mjedisor dhe social, duke mbështetur punonjësit dhe komunitetet dhe duke zhvilluar më tej praktikën e tij të matjes dhe raportimit të lidhura me klimën.

KEP Trust mbetet i përkushtuar ndaj rritjes së përgjegjshme, raportimit transparent dhe krijimit të vlerës afatgjatë për klientët, punonjësit, partnerët, komunitetet dhe palët e tjera të interesit.

Përgatitur nga: KEP Trust

Periudha e raportimit: 1 janar 2024 – 31 dhjetor 2025

© 2026 KEP Trust. Të gjitha të drejtat e rezervuara.